

SUPREME COURT OF KOSOVO
GJYKATA SUPREME E KOSOVËS
VRHOVNI SUD KOSOVA

KOSOVO PROPERTY AGENCY (KPA) APPEALS PANEL

KOLEGJI I APELIT TË AKP-së

ŽALBENO VEĆE KAI

GSK –KPA-A- 52/11

Prishtinë
26 gusht 2011

Në çështjen ligjore të

Z.B.

Parashtruese e kërkesës/ Ankuesja

Kolegji i Apelit i Gjykatës Supreme të Kosovës, në përbërje të Antoinette Lepeltier-Durel, Kryetare e Trupit Gjykues, Anne Kerber dhe Sylejman Nuredini, Gjykatës, duke vendosur me ankesën kundër vendimit të Komisionit për Kërkesa Pronësore i Kosovës KKPK/D/A/93/2009, (shkresat e lëndës të regjistruara në AKP me numrat KPA 27996, KPA 27999, KPA 28001, KPA 28009, KPA 28010, KPA 28012, KPA 28013 dhe KPA 28014), të datës 28 tetor 2010, pas shqyrtimit gjyqësor të mbajtur me 26 gusht 2011, lëshoi këtë

AKTGJYKIM

- 1. Refuzohet si e pabazë Ankesa e Z.B..**

2. Vërtetohet vendimi i Komisionit për Kërkesa Pronësore i Kosovës KPPK/D/A/93/2010, me datë 28 tetor 2010, sa i përket rasteve të regjistruara me numrat KPA27996, KPA27999, KPA 28001, KPA 28009, KPA 28012, KPA 28013 dhe KPA28014.

3. Shpenzimet e procedurës prej 180€ (njëqind e tetëdhjetë euro) duhet t'i mbuloj ankuesi, duke bërë pagesën në buxhetin e Kosovës brenda 90 dite nga dita e pranimit të aktgjykimit nën kërcënimin e përmbarrimit të detyrueshëm.

Përmbledhja faktike dhe procedurale:

Me 23 shkurt 2007 Z.B., duke vepruar si anëtar i familjes në emër të vjehrrit të saj të ndjerë, ka parashtruar tetë kërkesa në Agjencinë Kosovare të Pronës duke kërkuar që t'i njihet e drejta si pronare në disa ngastra të fituara me anë të trashëgimit dhe duke kërkuar riposedimin e tyre. Ajo ka shpjeguar se këto ngastra kanë qenë të vjehrrit të saj të ndjerë, S.B.. Ajo ka thënë se prona ishte uzurpuar pas përndjekjes së familjes në vitin 1999.

Në mbështetje të kërkesës se saj ajo ka dorëzuar në AKP këto dokumente:

- Certifikatën e Martesës
- Listën poseduese nr 20 të lëshuar nga Komuna e Istogut, Komuna Kadastrale e Belicës, me 8 gusht 1975.

Lista poseduese nr 20 tregon se ndër të tjerash S.B. ishte pronar edhe i këtyre ngastrave që i kërkon ajo:

Numri i ankesës dhe dosja e AKP-së	Shënim lidhur me ngastrën që kërkohet
GSK-KPA-A-52/11 (KPA27996)	Ngastra nr 940 tek vendi i quajtur "Glavica", Belicë, Istog, komerciale pa ndërtesë, një kopsht i pemëve i klasës së 4, me 18 ari e 12 m ² .
GSK-KPA-A-53/11 (KPA27999)	Ngastra nr 941 tek vendi i quajtur "Glavica", Belicë, Istog, komerciale pa ndërtesë, një arë e klasës së 7 me sipërfaqe prej 10 ari e 78m ² .
GSK-KPA-A-54/11 (KPA28001)	Ngastra nr 955 tek vendi i quajtur "Glavica", Belicë, Istog, komerciale pa ndërtesë, një arë e klasës së 6 me sipërfaqe prej 69 ari e 73m ² .

GSK-KPA-A-55/11 (KPA-28009)	Ngastra nr 981 tek vendi i quajtur "Smonica - Lojze", Belicë, Istog, komerciale pa ndërtesë, një mal i klasës 5, me sipërfaqe prej 6 ari e 20m ² .
GSK-KPA-A-56/11 (KPA28010)	Ngastra nr 982 tek vendi i quajtur "Smonica – Lojze", Belicë, Istog, komerciale pa ndërtesë, një arë e klasës së 7, me sipërfaqe prej 13 ari e 74m ² .
GSK-KPA-A-57/11 (KPA28012)	Ngastra nr 1000 tek vendi i quajtur "Smonica - Ledina", Belicë, Istog, komerciale pa ndërtesë, një arë e klasës së 7, me sipërfaqe prej 6 ari dhe 52m ² .
GSK-KPA-A-58/11 (KPA28013)	Ngastra nr 1225 tek vendi i quajtur "Smonica - Kod", Belicë, Istog, komerciale pa ndërtesë, një kopsht i klasës së 3, me sipërfaqe prej 72m ² .
GSK-KPA-A-59/11 (KPA28014)	Ngastra nr 1354/2 tek vendi i quajtur "Duboi Potoka", Belicë, Istog, komerciale pa ndërtesë, një mal i klasës së 3, me sipërfaqe prej 48 ari e 74m ² .

Më vonë, gjatë zhvillimit të procedurës parashtruesja e kërkesës ka dorëzuar edhe një certifikatë të vdekjes të lëshuar nga Republika Socialiste e Serbisë për Komunën e Istogut me 23 nëntor 2007 e cila tregon se N.B., gruaja e S.B., kishte vdekur me 2 janar 1998.

Në korrik (KPA27996, KPA27999) dhe tetor (të gjitha rastet tjera) 2007, ekipi për lajmërim i AKP-së ka dal tek vendet ku supozohet se gjenden ngastrat që kërkohen dhe kanë vendosur shenjat që tregojnë se prona është lëndë e një kërkesë dhe palët e interesuara duhej ta kishin dorëzuar përgjigjen e tyre brenda 30 dite. Gati e tërë prona ishte gjetur e pa uzurpuar, vetëm ngastra 941 (KPA27999), livadh, ishte e uzurpuar. Kur lajmërimi ishte përsëritur me 6 tetor 2009 (KPA27996, KPA27999), 16 tetor 2007 (KPA28009, KPA28010, KPA28012, KPA28013, KPA28014) dhe 13 maj 2010 (KPA28001), të gjitha ngastrat ishin gjetur të pa uzurpuara. Në rastet KPA27996, KPA27999 dhe KPA28001 lajmërimi ishte kontrolluar përmes hartës kadastrale, ortofotos dhe koordinatave të GPS dhe ishte gjetur në rregull.

Gjatë verifikimit të listës poseduese nr. 20 të dorëzuar, zyrtarët e AKP-së kanë gjetur listën poseduese nr. 80 të Kombeve të Bashkuara të lëshuar nga Komuna e Istogut për zonën Kadastrale të Belicës me 18 tetor 2007. Kjo listë poseduese tregon se të gjitha parcelat që kërkohen ishin në posedim të M.(S.)B., kunati i parashtrueses së kërkesës, dhe N.(S.)B., vjehrra e parashtrueses së kërkesës, si bashkë-pronarë secili me nga një pjesë ideale prej ½ .

AKP-ja ka kërkuar nga parashtruesja e kërkesës se a mund të dorëzoj certifikatën e vdekjes të vjehrrës së saj, se a kishte filluar ajo procedurën e trashëgimisë dhe nëse mund të sjell një autorizim nga trashëgimtarët e mundshëm bashkë me dokumentet që dëshmojnë lidhjet e tyre familjare. Parashtruesja e kërkesës u përgjigj se vjehrra e saj kishte vdekur në vitin 1999, se nuk ishte filluar procedura për trashëgimi dhe se kunati i saj kishte refuzuar t'ia jap autorizimin.

Me 28 tetor 2010, Komisioni për Kërkesa Pronësore i Kosovës (KKPK) me vendim e vet KKPK/A/93/2010 ka hedhë kërkesat. Sipas nr. 21 të këtij vendimi Komisioni ka deklaruar se pasi që parashtruesja e kërkesës nuk e kishte dorëzuar certifikatën e vdekjes të vjehrrit të saj, vdekja e tij nuk ishte dëshmuar. Meqë ishte kuptuar se prona tani është e regjistruar në emrin e vjehrrës së parashtrueses së kërkesës dhe të kunatit të saj, KKPK-ja ka gjetur se parashtruesja e kërkesës nuk ishte në marrëdhënie familjare me asnjërin nga titullarët e së drejtës në pronë. Duke qenë se parashtruesja e kërkesës nuk kishte mundur të parashtroj autorizimin e asnjërit titullar të së drejtës në pronë përveç certifikatës së vdekjes për vjehrrën e saj, KKPK-ja deklaroi se parashtruesja e kërkesës nuk kishte vërtetuar mundësinë e saj për të paraqitur kërkesë në emër të titullarëve të së drejtës në pronë (neni 5.2 i Rregullores së UNMIK-ut AD 2007/5 të ndryshuar me Ligjin 03/L-079.

Vendimi parashtrueses së kërkesës iu është dorëzuar me 13 prill 2011. Me 11 maj 2011, parashtruesja e kërkesës (në tekstin e mëtejme: ankuesi) ka parashtruar tetë ankesa identike në Gjykatën Supreme, ku secila nga to përmbante nga një kërkesë të ndryshme.

Ankuesi tashmë kërkonte që Gjykata Supreme t'ia njeh bijës së saj, L.J., të drejtën e riposedimit të pronës se regjistruar si prona e N.B. që gjendet në Komunën Kadastrale të Belicës.

Ankuesja ka shpjeguar se vjehrra i saj, S.B., kishte vdekur me 30 maj 1964 ndërsa burri , R.B., i kishte vdekur me 17 janar 1996 në Veliko Gradiste, kurse vjehrra e saj kishte vdekur me 2 janar 1998 në Istog.

Ajo ka dorëzuar një Certifikatë të Vdekjes të lëshuar me 4 maj 2011 nga Republika e Serbisë, Komuna e Istogut, që vërteton se S.B. kishte vdekur me 30 maj 1964, në or 12:00 në Belicë; një Certifikatë të Vdekjes të lëshuar me 24 janar 1996 nga Republika Federative e Jugosllavisë, Komuna Veliko Gradiste, që dëshmon se R.B. kishte vdekur me 17 janar 1996 dhe një Certifikatë të vdekjes të lëshuar me 23 nëntor 2007 nga Republika e Serbisë, Komuna e Istogut, që dëshmon se N.B. kishte vdekur me 2 janar 1998.

Në ankesën e saj, ankuesja më tej ka deklaruar se ajo tani do të dorëzonte kërkesën jo në emrin e saj apo të vjehrrit, por në emër të bijës së saj, L.J., e lindur B., e cila supozohet se ishte trashëgimtare ligjore e gjyshes së saj N.B.. Ankuesja ka deklaruar, pa dhënë shpjegime tjera, se bija e saj nuk ka mundur të parashtroj kërkesën në kohën e duhur. Ankuesja ka sjellë në gjykatë një Certifikatë të Martesës së bijës si dhe një autorizim me të cilin L.J. autorizon ankuesen të parashtroj në emër të saj tetë kërkesat që përbëjnë lëndën e këtij vendimi.

Gjykata Supreme i ka bashkuar kërkesat.

Arsyetim Ligjor

Ankesa është e lejueshme. Ajo është paraqitur brenda periudhës prej 30 ditësh të caktuar në nenin 12.1 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 të ndryshuar me Ligjin 03/L-079.

Sidoqoftë, ankesa është e pabazë. Rasti nuk është nën juridiksionin e KKPK-së.

Sipas nenit 3.1 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 të ndryshuar me Ligjin 03/L-079, parashtruesit të kërkesës ka të drejtë në urdhrin për riposidim të pronës nga Komisioni nëse parashtruesi i kërkesës jo vetëm se dëshmon pronësinë e një pronë të paluajtshme private por edhe kur ai ose ajo tani nuk ka mundësi të ushtroj ato të drejta pronësore për shkak të rrethanave të lidhura drejtpërsëdrejti me ose nga konflikti i armatosur në Kosovë ndërmjet 27 shkurtit 1998 dhe 20 qershorit 1999.

Por, në këtë rast parashtruesja e kërkesës nuk ka dëshmuar që ajo ose bija e saj kanë qenë të kufizuara në ushtrimin e të drejtës së pronës që kërkohet nga shkaku i konfliktit të armatosur ndërmjet vitit 1998/1999. Faktet e paraqitura me të vërtetë tregojnë se shkaku për humbjen e pronës së supozuar nga parashtruesja e kërkesës është një kontest që ka të bëjë me trashëgimin e vjehrrit të parashtrueses së kërkesës, S.B., i cili ka vdekur në vitin 1964. Megjithatë, ngastrat e kërkuara nuk janë gjetur të regjistruara në emrin e gruas së tij, vjehrrës së paraqitësit të kërkesës, as në emër të dy fëmijëve të tij, përfshirë edhe burrin e ndjerë të parashtrues së kërkesës, por vetëm në emër të vjehrrës së parashtrueses së kërkesës dhe kunatit të saj. Prandaj, humbja e ngastrave nga pronësia e burrit të parashtrueses së kërkesës dhe vetë asaj nuk rrjedh nga konflikti i armatosur në Kosovë, por nga fakti se burri i parashtrueses së kërkesës nuk ishte përfillur gjatë ndarjes të ngastrave në fjalë pas vdekjes së vjehrrit të saj. Ky përfundim mbështet me faktin se kunati i parashtrueses së kërkesës ka refuzuar t'ia jap asaj autorizimin. Kjo tregon se familja nuk pajtohet me rrjedhën e veprimit lidhur me ngastrat e kërkuara dhe lë të kuptoj një kontest të supozuar të trashëgimisë. Së fundi, fakti që ngastrat e

kërkuara nuk janë gjetur të uzurpuara tregon se humbja e supozuar e pronës nuk është rezultat i konfliktit të armatosur të vitit 1998/1999.

Arsyetimi i njëjtë vlen edhe për bijën e parashtrueses së kërkesës dhe trashëgiminë e pronës së supozuar të N.B. nga ajo (gjyshja e saj dhe vjehrra e parashtrueses së kërkesës). Nga faktet e paraqitura duhet të përfundohet se shkak që ai supozohet se nuk mund të ushtroj të drejtën e pronësisë që kërkon nuk është konflikti i armatosur në Kosovë por një kontest i trashëguar brenda familjes.

Sidoqoftë KKPK-ja nuk duhet të vendos lidhur më këto konteste të trashëgimisë.

Pasi që kërkesa nuk bie në kompetencën e KKPK-së, Gjykata nuk duhet të vendos se a mund ndryshimi fundamental në kërkesë (këtu: këmbimi i së drejtës së supozuar pronësore si dhe këmbimi i poseduesit të supozuar të së drejtës në pronë) të ketë efekt të vlefshëm në rastet ku ky ndryshim bëhet (a) pas afatit për parashtrimin e kërkesave i caktuar në Nenin 8 të Urdhëresës Administrative të UNMIK-ut 2007/5 të ndryshuar me Ligjin Nr. 03/L-079 dhe (b) vetëm në rastin e dytë të procedurës.

Shpenzimet e procedurës

Në pajtim me Aneksin III, neni 8.4 të Udhëzimit Administrativ (AD) 2007/5 të ndryshuar me Ligji Nr 03/L-079, palët lirohen nga shpenzimet e procedurës para Sekretarisë ekzekutive dhe Komisionit.

Mirëpo në procedurën para Kolegjit të Apelit nuk parashihet lirimi nga shpenzime. Prandaj, regjimi normal i pagesave për taksat gjyqësore të parapara nga Ligji mbi Pagesat e Gjykatës (Gazeta Zyrtare e KSAPK, 3 tetor 1987) dhe nga UD Nr. 2008/02 të Këshillit Gjyqësor të Kosovës mbi Unifikimin e pagesave të Gjykatës janë të zbatueshme ndaj procedurave që sillen para Kolegjit të Apelit.

Kështu, për shpenzimet e procedurës së kësaj ankese duhet paguar këto pagesa:

- taksa nga tarifa gjyqësore për parashtrimin e ankesës (Neni 10.11 UA 2008/2) 30€
- taksa gjyqësore për lëshimin e aktgjykimit (Neni 10.21, dhe 10.1 i UA 2008/2), duke marrë parasysh që vlera e pronës në fjalë mund të llogaritet arsyeshëm në vlerë prej 20.000 €: 150€ (50€ +0,5% nga 20.000€)

Këto taksa gjyqësore i paguan ankuesi që e humb rastin. Sipas Nenit 46 të Ligjit mbi Taksat Gjyqësore, afati i fundit për pagesat e taksave të për personin që është me banim jashtë Kosove nuk mund të jetë më pak se 30 ditë dhe jo më gjatë se 90 ditë. Gjykata Supreme vendosi që në rastin konkret tarifat gjyqësore i paguan ankuesi brenda 90 ditësh nga dita kur atij i dorëzohet aktgjykim.

Këshillë Juridike

Në bazë të Nenit 13.6 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 të ndryshuar me Ligjin 03/L-079, ky aktgjykim është i formës së prerë dhe i zbatueshëm dhe si i tillë nuk mund të kundërshtohet as me mjete të rregullta as mjete të jashtëzakonshme ligjore.

Nënshkruar nga: Antoinette Lepeltier-Durel, Kryetare e trupit gjykues i Euleksit

Nënshkruar nga: Anne Kerber, Gjyqtare e EULEX-it

Nënshkruar nga: Sylejman Nuredini Gjyqtar

Nënshkruar nga: Urs Nufer, Regjistruer i Eulex-it